



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.351/04-91680/25 dt.25.06.2025, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Salih Berisha, Sabit Mustafa, Hajrije Durmish, Agim Bunjaku, Avdullah Mustafa, Shefqet Malushaj, Flamur Rexhepi, Ismet Gashi, Arbnore Berisha, Fjolla Thaçi, Egzon Thaçi, Miradije Xhumshiti, Bedrije Xhumshiti, Shaban Terkalac, Abdilj Trkaljaq dhe Agron Terkalaq, investitorit ”In On” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Lord Bajroni”, nr. 97, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810837685, me perfaqësues Besnik Thaçi, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, gjegjësisht faza II-të e kompleksit “In On”- Lam. “B”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A”, Tërësia “A / a-3”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në rr. “Qamile Jaka” dhe “Latif Berisha”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 18.07.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. ILEJOHET kërkuësve / bashkëpronarëve, Salih Berisha, Sabit Mustafa, Hajrije Durmish, Agim Bunjaku, Avdullah Mustafa, Shefqet Malushaj, Flamur Rexhepi, Ismet Gashi, Arbnore Berisha, Fjolla Thaçi, Egzon Thaçi, Miradije Xhumshiti, Bedrije Xhumshiti, Shaban Terkalac, Abdilj Trkaljaq dhe Agron Terkalaq, investitorit ”In On” sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. “Lord Bajroni”, nr. 97, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810837685, me perfaqësues Besnik Thaçi, sipas kërkesës 05Nr.351/04-91680/25 dt.25.06.2025, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, gjegjësisht faza II-të e kompleksit “In On”- Lam. “B”, me etazhitat 2B+S+P+14, e ndërtuar sipas “Vendimit për Lejimin e Ndërtimit” 05 Nr. 351/02-87026/20 dt. 09.12.2020, dhe “Vendimi për ndryshim - plotësimi i dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, miratuar me vendimin e lejeve ndërtimore 05Nr.351/02 – 87026/20 dt.09.12.2020 si dhe korrigjimi i pranimi teknik, 05Nr.351/05-239641/21 dt.03.12.2021, në parcelën kadastrale nr. 10430-0, (në bashkëpronësi Salih Berisha, Agron Trkalaq, Abdilj Trkalaq, Shaban Terkalac, Bedrije Xhumshiti, Miradije Xhumshiti, Fjolla Thaçi, Arbnore Berisha, Flamur Rexhepi, Florim Grajçevci, Shefqet Malushaj, Avdullah Mustafa, Agim Bunjaku, Hajrije Durmishi, Drita Gashi, Drita Nikolla, Semavi Shabani, Nexhmedin Gashi, Sabit Mustafa, Sylejman Berisha, Shaban Statovci, Visar Statovci, Fatime Statovci, Afërdita Statovci, Merita Zharku, Arbër Statovci, Kastriot Grajçevci, Gëzim Thaqi, Drita Gashi, Labinot Grajçevci, Zylfije Grajçevci, Avdush Gashi, “In On” shpk), ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A”, Tërësia “A / a-3”, të Planit Rregullues “Muhaxhirët”, në Prishtinë.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Qamile Jaka”, ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 19, 21, 23, dhe 25, dhe në rrugën “Latif Berisha”, ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 4, dhe 6, në Prishtinë, dhe e njejta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuesit / bashkëpronarët, Salih Berisha, Sabit Mustafa, Hajrije Durmish, Agim Bunjaku, Avdullah Mustafa, Shefqet Malushaj, Flamur Rexhepi, Ismet Gashi, Arbnore Berisha, Fjolla Thaçi, Egzon Thaçi, Miradije Xhumshiti, Bedrije Xhumshiti, Shaban Terkalac, Abdilj Trkaljaq dhe Agron Terkalaq, investitorit "In On" sh.p.k., me seli në Prishtinë, në rr. "Lord Bajroni", nr. 97, me certifikatë të regjistrimit të biznesit 810837685, me perfaqësues Besnik Thaçi, me kërkesën 05 Nr. 351/02-87026/20 dt. 09.12.2020, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, gjegjësisht faza II-të e kompleksit "In On"- Lam. "B", me etazhitat 2B+S+P+14, e ndërtuar në kuadër të bllokut urban "A", Tërësia "A / a-3", të Planit Rregullues "Muhaxhirët", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10430-0, (në bashkëpronësi Salih Berisha, Agron Trkalaq, Abdilj Trkalaq, Shaban Terkalac, Bedrije Xhumshiti, Miradije Xhumshiti, Fjolla Thaçi, Arbnore Berisha, Flamur Rexhepi, Florim Grajçevci, Shefqet Malushaj, Avdullah Mustafa, Agim Bunjaku, Hajrije Durmishi, Drita Gashi, Drita Nikolla, Semavi Shabani, Nexhmedin Gashi, Sabit Mustafa, Sylejman Berisha, Shaban Statovci, Visar Statovci, Fatime Statovci, Afërdita Statovci, Merita Zharku, Arbër Statovci, Kastriot Grajçevci, Gëzim Thaqi, Drita Gashi, Labinot Grajçevci, Zylfije Grajçevci, Avdush Gashi, "In On" shpk), ZK Prishtinë, ndërtuar sipas "*Vendimit për Lejimin e Ndërtimit*" 05 Nr. 351/02-87026/20 dt. 09.12.2020, dhe "*Vendimi për ndryshim - plotësimi i dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, miratuar me vendimin e lejeve ndërtimore 05Nr.351/02 – 87026/20 dt.09.12.2020 si dhe korrigjimi i pranimi teknik*", 05Nr.351/05-239641/21 dt.03.12.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-0105180/24 dt. 28.02.2025, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Arjeta Nuredini; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Nasip Mustafa; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Lavdit Sherifi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Avdurrahman Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bekim Tola; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodete e licensuar "Geo – Group" shpk, me nr. të licensës 52;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me

dokumentacionon ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-91680/25 DT. 18.07.2025

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu

B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



